

NË KËTË EDICION:

» AKTIVITETET E NRC-SË

- Shërbimi Ligjor
- Akademia e OJF-ve 2024
- Asistencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë
- EU aquis, angazhimi dhe roli i OSHC-ve në procesin e integritetit të vendit në BE
- Asistencë Teknike për rrjetet e OSHC-ve

» ZHVILLIMET E FUNDIT NË SEKTOR

- Mbi vendimin Nr. 455, datë 24.07.2023 "Për miratimin e formularëve standard të regjistrit elektronik të organizatave jofitimprurëse"
- Udhërrëfyesi për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike
- Mbi Ndryshimet e Rekomandimit 8 dhe Dokumentit të Praktikave më të Mira të FATF gjatë Vitit 2023
- Takimi i parë i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile për vitin 2024
- Takimi rajonal "Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe Ndikimi i tij në përshejtimin e reformave të Shtetit të së Drejtës"
- Tacso 3 - Zhvillime të reja



Java e Shoqërisë Civile 2024! Për të tretin vit radhazi, rikthehet Java e Shoqërisë Civile në Shqipëri!

Me një seri eventesh realizuar nga organizata të shoqërisë civile në të gjithë vendin, midis datave 27 maj - 2 qershor 2024.

Java e Shoqërisë Civile 2024 krijon mundësi për rrjetëzime dhe dialog ndërinstitucional për çështje me rëndësi për sektorin e më gjerë.

Çdo vit, përzgjidhet një tematikë në linjë me aktivitetet ndërkombëtare si dhe zhvillime të rëndësishme në vend apo në sektorin e shoqërisë civile.

Këtë vit, Java e Shoqërisë Civile do të konceptohet si një hapësirë reflektimi mbi zhvillimet dhe ndryshimet e mundshme të ndodhura përgjatë një viti, me fokus "**Aftësi për të gjithë: Për të mësuar, punuar, angazhuar**", në vazhdimësi së JSHC të vitit të shkuar.

Për të gjitha organizatat e interesuara për t'u bërë pjesë e Javës, gjeni këtu [Broshurën Informuese](#), si dhe [Formularin e Aplikimit](#), ose na shkruani në info@resourcecentre.al.

Për më shumë mbi eventin e vitit të kaluar, gjeni [këtu](#) Përmbledhjen e Java e Shoqërisë Civile 2023!



Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, përgjatë 2023!

Kemi kënaqësinë të ndajmë me ju një [përmbledhje të rezultateve të punës së Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile](#), përgjatë 2023.

Përgjatë 2024 do të vijojmë ofrimin e shërbimeve tona përmes zyrës sonë qendrore në Tiranë si dhe dy zyrave rajonale në Shkodër dhe Vlorë.

Për t'u bërë pjesë e programeve tona na shkruani në info@resourcecentre.al



Raport "Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri"

Në vijim të punës dhe të përpjekjeve së saj në mbështetje të fuqizimit të kapaciteteve të sektorit, përgjatë muajit janar-shkurt 2024, QKB zhvilloi studimin mbi "Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri".

Njihuni me gjerësisht me gjetjet e raportit [këtu](#).



SHËRBIMI LIGJOR

Qendra Kombëtare Burimore vijon ofrimin e shërbimit ligjor për OJF-të dhe aktivistët e shoqërisë civile. Shërbimi Ligjor ofrohet çdo të mërkurë, ONLINE, nga ora 14.00-17.00. Për më shumë informacion mbi shërbimin ligjor dhe si të përfitonit prej tij, [lexoni këtu](#).



AKTIVITETE NGA ZYRAT RAJONALE TË QENDRËS KOMBËTARE BURIMORE PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



Zyra Rajonale Vlorë përgjatë takimit me Forumin e Pavarur të Grave të Orikumit për të diskutuar nevojat prioritare të komunitetit dhe çështjet që duhet të adresohen nga Bashkia Vlorë.



Zyra rajonale Vlorë, pjesë e Mekanizmit të Referimit kundër dhunës me bazë gjinore, gjatë fushatës së ndërgjegjësimit të organizuar nga Qendra Psiko-Sociale "Vatra" në rastin e 8 Marsit.



Takim me përfaqësuesen e re të Zyres së Avokatit të Popullit në Vlorë për të prezantuar veprimtarinë e Qendrës Kombëtare Burimore dhe për të diskutuar mundësitë për forcimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve.



Shërbim mbështetës dhe informim me përfaqësues të "YMCA Shkodër" për organizimin e trajnimeve për gazetarët në qytetin e Shkodrës.



Shërbim mbështetës dhe informim me përfaqësues të shoqatës "Me Ju Për Ju" mbi thirrjet për projekte dhe organizatat që ofrojnë shërbime për fëmijët autikë në Shkodër.



Zyra Rajonale Shkodër përgjatë sesionit informues me të rinjtë e Shkodrës mbi aktivizmin qytetar dhe vullnetarizmin.

AKTIVITETET E QKB

QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËRGJATË VITIT 2023



- 573** Kërkesa të adresuara ONLINE dhe ONSITE
 - 270** OJF dhe aktivistë të asistuar
 - 25** Kërkesa për Këshillim Ligjor
- 273** Thirrje për Projekt Propozime, Njoftime për Konsultime Publike, Mundësi Trajnimi, Evente, Studime etj., të NDARA me sektorin
- 27** Takime dhe Forume lokale
- 574** OSHC, Aktivistë dhe Grupe Interesi Pjesëmarrës
- 165** Regjistrime në Direktorinë online të OJF-ve

AKADEMIA E OJF-VE 2024

“

Gjatë muajve shkurt dhe mars janë zhvilluar tre leksionet e para respektivisht mbi "Kuari Ligjor për OJF-të në Shqipëri", "Anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe roli i OSHC-ve" , si dhe "Zhvillimi dhe Manaxhimi Organizativ".



Kuari ligjor për OJF-të në Shqipëri



Antarësimi në BE dhe roli i OSHC-ve



Zhvillimi dhe Manaxhimi Organizativ

ASISTENCË DHE MENTORIM PËR PJESËMARRRËSIT E AKADEMISË

Në vijim të leksioneve të para, janë zhvilluar dhe seancat respektive të mentorimit me akademistët. Disa nga aspektet kryesore të diskutuara gjatë seancave të mentorimit kanë qenë mbi regjimin tatimor, deklarimet përkatëse, pjesëmarrjen e OSHC-ve në procesin e konsultimeve në kuadër të Integritimit Evropian, të drejtën e informimit dhe konsultimit publik në Shqipëri, si dhe manualin e procedurave të brendshme organizative dhe zhvillimin e politikave të personelit.



EU AQUIS

ANGAZHIMI DHE ROLI I OSHC-VE NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË VENDIT NË BE




Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Qendra Kombëtare Burimore, në kuadër të programit të fuqizimit të kapaciteteve të OSHC-ve për tu përfshirë dhe kontribuar në procesin e integritimit në BE, kanë vijuar me organizimin e workshopeve mbi masat prioritare strategjike dhe politike gjatë hartimit dhe miratimit të Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës, si dhe hapat e mëtejshëm për t'i realizuar. Gjithashtu, është theksuar edhe rëndësia e përfshirjes së shoqërisë civile në konsultimin dhe monitorimin e Tryezës themeluese të kapitullit 24 në kuadër të Platformës së Partneritetit.

MBËSHTETJE PËR RRJETET, KOALICIONE DHE GRUPIMET E OSHC-VE



Grupimi informal "Pa plastikë, me natyrën, për shëndetin" në Korçë, me mbështetjen dhe lehtësimin e Qendrës Kombëtare Burimore, pas përfundimit të planit të advokimit po vijon me zbatimin e nismës për reduktimin e ndotjes së mjedisit në rajonin e Korçës, veçanërisht atij nga përdorimi i qeseve plastike. Një sërë takimesh janë organizuar me aktorë dhe grupe interesi për t'u bërë bashkë dhe mobilizuar në këtë nismë. Institucioni i Prefekturës Korçë, pas takimit me përfaqësues të grupimit, ka vlerësuar nismën dhe krijimin e një rrjeti lokal gjithëpërfshirës me aktorë lokalë kyç si komuniteti, biznese lokale, institucione përgjegjëse dhe ekspertë të fushës dhe akademisë.

Krijimi i Grupimit "Pa plastikë, me natyrën, për shëndetin" është nismë e Act Think Center në bashkëpunim me organizata të tjera lokale si Korça Alpin, Shtëpia e Gjellbër dhe ekspertë të çështjeve mjedisore e aktivistë në qytetin e Korçës. Synimi i tyre është rritja e ndërgjegjësimit për ndotjen e mjedisit në këtë rajon dhe lobimi për marrjen e masave për minimizimin e saj.




Prej muajit Dhjetor 2023, një tjetër koalicion i është bashkuar programit të Asistencës për Rrjetet e OSHC-ve. Koalicioni Kombëtar për Integrimin e Romëve në Shqipëri, një rrjet informal i përbërë nga 10 organizata nga mbarë vendi që punojnë kryesisht në fushën e të drejtave të komunitetit Rom dhe Egjiptian, ka ndërmarre një nismë advokuese për integrimin dhe nxitjen e praktikave të suksesshme për integrimin e këtij komuniteti. Rënia e ndjeshme e pjesëmarrjes së të rinjve Rom dhe Egjiptian në arsimin e lartë, u vlerësua si një prioritet kyç për t'u adresuar, kjo nisur dhe nga periudha aktuale e draftimit të udhëzimeve për vitin e ri akademik universitar.

Pas një analize të detajuar gjithëpërfshirëse të çështjes, në mars të këtij viti, koalicioni i'u drejtua me një letër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Bazuar dhe në përputhje me dispozita ligjore të ngjashme për minoritetet (si ajo e të diplomuarve nga zonat shqipfolëse), koalicioni propozon përjashtimin ose uljen e mesatares si kriter pranues në arsimin e lartë për të rinjtë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian. Momentalisht kërkesa është pranuar dhe pritet një përgjigje për të diskutuar më tej.

LETËR

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR MBI VENDIMIN NR.455



Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, si pjesë e punës së saj për monitorimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri, identifikoi miratimin e Vendimit Nr. 445, datë 24.07.2023 "Për miratimin e formularëve standard të regjistrimit elektronik të organizatave jofitimprurëse", në funksion të krijimit të regjistrimit elektronik për organizatat jofitimprurëse në vend sipas Ligji Nr. 80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse". Për më shumë [lexo këtu](#).

MBI NDRYSHIMET E REKOMANDIMIT 8 DHE DOKUMENTIT TË PRAKTIKAVE MË TË MIRA TË FATF GJATË VITIT 2023!

Ky dokument thekson fokusin kryesor të Rekomandimit 8 nga perspektiva e Organizatave Jofitimprurëse, duke analizuar se si dhe pse rekomandimi duhet të interpretohet përmes një vëzhgimi kritik. Ky vështrim ofron paragrafë me informacion të dobishëm për autoritetet përgjegjëse, bankat dhe palët e tjera të interesit. [Lexoni këtu dokumentin](#) informues të përgatitur nga Qendra Evropiane për Ligjin Jo-fitimprurës (ECNL), dhe përkthyer në shqip nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim.

TAKIMI I PARË I KËSHILLIT KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE PËR VITIN 2024



Në takimin e parë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile për vitin 2024, të mbajtur në Tiranë më 12 shkurt, u diskutua për problematikat lidhur me regjistrin elektronik të OJF-ve, zbatueshmërinë e Ligjit përjashtues të TVSH-së për OSHC-të, përditësimin e Udhërrëfyesit të Ri për Shoqërinë Civile, propozimet për kalendarin e veprimtarisë së KKShC-së për këtë vit, si dhe për ndryshimet në Ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura". Për më shumë, [lexo këtu rreth takimit](#) dhe [këtu rreth procesverbalit](#) të mbajtur sipas rendit të ditës dhe diskutimeve të këshillit.

TAKIMI RAJONAL "PLANI I RITJES PËR BALLKANIN PERËNDIMOR DHE NDIKIMI I TIJ NË PËRSHPEJTIMIN E REFORMAVE TË SHTETIT TË SË DREJTËS"



Këshilli Kombëtar i Integritit European (KKIE) dhe European Movement Albania (EMA) organizuan takimin rajonal me temën "Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe ndikimi i tij në përshtetimin e reformave të shtetit të së drejtës". Takimi, i cili u mbajt më 12 mars, u fokusua në diskutimin e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik rajonal për përparimin e reformave të shtetit të së drejtës. [Për të mësuar më shumë për takimin, lexoni këtu](#).

TACSO 3 - ZHVILLIME TË REJA

Gjatë tremujorit të parë të 2024, TACSO 3 ka organizuar një seri aktivitete për OSHC-të në rajon me fokus zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve dhe praktikave kombëtare të ndërtimit të kapaciteteve.

Ndër takimet dhe aktivitetet kryesore përmendim: Takimin Konsultues të "Komunitetit të Praktikave të Qeverisjes"; Takim mbi "Udhëzimet e DG Near dhe mbështetjen e shoqërisë civile për vitin 2023"; Takim mbi "Rregullat e Vizibilitetit të BE-së" etj. [Për më shumë, ndiqni këtu, lajmet më të fundit nga Tacso](#).





KALENDAR TREMUJOR

SHËNONI NË KALENDARIN TUAJ! PËRFSHIHU NË AKTIVITETET TONA TË ARDHSHME!

MAY 2024						
SUN	MON	TUE	WED	THU	FRI	SAT
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

Qershor 2024						
SUN	MON	TUE	WED	THU	FRI	SAT
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

Korrik 2024						
SUN	MON	TUE	WED	THU	FRI	SAT
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

 Akademia e OJF-ve  Trajnime dhe Seminare për OShC-të  Advokim & rrjetëzim  Forume publike dhe evente

Zyra në Tiranë

Rruga e Elbasanit, PARK GATE,
Kati i 10të, Ap. 73, Tiranë
(në mjediset e "Partnerët
Shqipëri për Ndryshim dhe
Zhvillim")

Tel/Fax: +355 4 2254881

E-mail: info@resourcecentre.al

Zyra në Shkodër

Lagjja Kongresi i Përmetit, Rr.
Oso Kuka, Kati i 2të, Hyrja 1,
Shkoder
(në mjediset e Shoqatës
"Gruaja në Zhvillim")

E-mail:
shkodra@resourcecenter.al

Zyra në Vlorë

Lagjja 29 Nëntori, Rr. Dede
Ahmet Amataj, Çerdhja 15, Kati i
2të, Vlorë
(në mjediset e Qendrës "Aulona")
Tel: +355 3 3224531

E-mail: vlor@resourcecenter.al

